

MUNGESA E IDEOLOGJIVE TEK PARTITE POLITIKE NË SHQIPERI LACK OF IDEOLOGIES OF POLITICAL PARTIES IN ALBANIA

ROLAND LAMI

Universiteti U.F.O, Tirane, Shqipëri

PËRMBLEDHJA

Fokusi i analizës në këtë material ka të bëjë me shqyrtimin në rrafshin teorik dhe praktik i raportit që ekziston ndërmjet politikës dhe ideologjisë në Shqipëri. Fillimisht, do të prezantohen disa koncepte kyçe ku mbështetet ideologjizimi si dhe rëndësia e tyre në formimin e ndarjes ndërmjet të majtës dhe të djathtës. Në këtë punim janë analizuar disa faktorë kryesorë, të cilët kanë influencuar negativisht në drejtim të moskonturimit të ideologjisë. 1. Globalizimi; 2. Integrimi Euro-Atlantik; 3. Struktura sociale; 4. Mungesa e organizimit të grupeve të interesit; 5. Situata ekonomike dhe sociale e vendit; 6. Fragmentarizimi i tregut politik.

SUMMARY

The ideology is an essential element related to the politics. The ideology take sense when it is based on the political programs. In Albania, the relation between politics and ideology is not clear. The political forces that represent the left wing can easy go across the right wing and at the same time, vice versa. In this study, some main factors have been analysed; they have had a negative impact on the absence of ideology. They are as follows: 1. Globalisation; 2. Euro-atlantic Integration; 3. Social structure; 4. Lack of organisation of interest groups; 5. Economic and social situation of the country; 6. Fragmentation of political trade.

Fjalët kyçe: Ideologji, Integrimi Euro-Atlantik, Grupe të interesit, Fragmentarizim

Metodologjia

Hipoteza bazë e studimit ka një natyrë komplekse për shkak të numrit të variablave të pavarura që e përbëjnë atë. Marrëdhëniet ndërmjet variablave për efekt studimi janë shqyrtuar sipas modelit të hipotezës së thjeshtë – tipi i lidhjes ndërmjet variabël së pavarur dhe asaj të varur. Metodologjia që është aplikuar në

këtë trajtesë është bazuar kryesishtë në analizën sekondare. Dokumentat, artikujt, studimet, raportet, revistat dhe gazetat kanë përbërë bazën e sigurimit të fakteve dhe provave. Gjithashtu, në studim përveç shfrytëzimit të materialeve të publikuara nga institucione të ndryshme kërkimore, si burim informacioni kanë shërbyer edhe këndvështrimi i paraqitur nga autorë të njohur që janë marrë me trajtimin dhe komponentët që konturojnë ideologjinë.

Hyrje

Ideologjia drejton veprimin politik dhe vendos parametrat e vlerësimit të këtij veprimi. Termi ideologji është krijuar nga mendimtari francez Claude Destutt de Tracy në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Sipas tij ideologjia është shkencë e ideve dhe e origjinës së tyre. Ai besonte se është e mundur të zbulohet objektivisht prejardhja e ideve dhe se kjo shkencë e ideve ka probabilitet të gëzojë të njëjtën saktësi dhe status si shkencat natyrore.

Funksioni i ideologjive sipas tij lidhet me dy dimensione; përcaktimi i qëllimeve me synim projektimin e funksionimit të shoqërisë në të ardhmen dhe përzgjedhja e metodave efikase për të arritur këto qëllime në fusha të tilla si : ekonomia, edukimi, kujdesi shëndetësor, sistemi i drejtësisë, siguria sociale, ekonomia e tregut, emigracioni, mbrojtja e ambjentit, feja etj. Për të klasifikuar ideologjitë politike si dhe politikat që prodhohen prej tyre ekzistojnë disa mënyra. Pjesa më e madhe e studiuesve bien dakort përse i përket klasifikimit të ideologjisë duke i ndarë në politika të majta dhe të djathta. Përmbledhtazi po paraqesim disa pika që ndajnë të majtën nga e djathta referuar Lijphart .

Barazia

E majta- Përpiqet të çrrënjos pabarazitë sociale

E Djathta- I sheh pabarazitë sociale si rezultat i pabarazive natyrore të paçrrënjësishme

Shpenzimet publike

E majta- Rritja e shpenzimeve publike në sferat sociale dhe rishpërndarje intensive e të ardhurave

E djathta- Shkurtimi i shpezieve publike dhe reduktim i politikave sociale

Korporatizmi

E majta -Mbështetje për arsye të rolit të tyre të spikatur

E djathta- E interesuar për të në mënyrë të kufizuar
Mjedisi

E majta - E ndjeshme ndaj kërkesave të të gjelbërëve dhe është për krijimin e koalicionëve me të gjelbërit.

E djathta - Pak e interesuar dhe kundërshtuese e kufizimeve ekologjike ndaj sipërmarrjes së lirë

Sigurimet sociale

E majta- Universale, me përfitime të lidhura me të ardhura të larta

E djathta- Shtrirje e kufizuar, me përfitime të ulëta

Mbi bazën e perceptimit dhe rëndësisë së ndryshme që i japin këtyre koncepteve bëhet dallimi midis liberalëve të djathtë dhe socialistëve të majtë. Sic del në pah edhe nga komponentët e paraqitur më lartë, kostatohet fakti se liberalët klasik dhe neoliberalët fokusohen kryesisht në rolin qëndror të lirisë dhe në kufizimin e qeverisë dhe të forcës shtrënguese të shtetit. Ndërsa socializmi vendos si përparësi barazinë sociale dhe lë në plan të dytë lirinë.

Pavarësisht, këtyre dallime ideologjike të paraqitura në planin teorike, shumë autorë të tjerë kanë parashikuar ose përshkruar fundin e ideologjive. Termi “ Fundi i ideologjisë” mund të jetë hasur së pari në shkrimet e eseistit e romancierit francez Albert Kamy në kritikën e tij për socialistët francezë. Vite më vonë një profesor i Harvardit Stuart Hughes e rimori këtë koncept në esenë e tij “Fundit i ideologjisë politike” Më vonë Seymour Martin Lipset argumentoi që problemet politike themelore të zhvillimit industrial nuk ngrenë më debate apo konflikte ideologjike, por një formulim më të mprehtë të këtij koncepti e ka dhënë Daniel Bell në librin e tij “Fundit i Ideologjisë.” Ideologjitë e vjetra të shekullit të nëntëmbëdhjetë janë minuar nga tmerrri i komunizmit sovjetik dhe suksesi i kapitalizmit liberal. Bell shprehet: “...pasionet e vjetra janë shuar” dhe radikalizmi i vjetër politik ekonomik e ka humbur kuptimin e vet. Sipas tij situata duket e qartë; “Koha e ideologjive ka mbaruar”

Gjithashtu, një tjetër skeptik Francis Fukuyama riformuloi në mënyrë më të zbukuruar propozimin e fundit të ideologjisë. Në një artikull që i paraprin librit “The End of History and the Last Man”, Fukuyama shprehet se “...triumfi i perëndimit dhe ideve perëndimore është i dukshëm në eliminimin total të alternativave të mundshme ndaj Liberalizmit Perëndimor.” Në fakt ky është dhe argumenti i Bell, i

cili shprehet se fitorja e kapitalizmit eliminonjë alternativat ideologjike.

Faktikisht, kompleksiteti teknik dhe ekonomik në rritje, kanë bërë të domosdoshme sjelljen pragmatiste, zgjidhjet larg ideologjive dhe largimin nga utopitë shoqërore. Shoqëritë industriale perëndimore janë zhvilluar në një shoqëri të nivelizuar shtresash të mesme me marrëdhënie relativisht të homogjenizuara ku ballafaqimet ideologjike e kanë humbur mjaft rëndësinë e tyre. Në vështrimin politik, partitë social demokrate apo socialiste në demokracitë perëndimore janë orientuar drejtë koncepteve liberale duke braktisur trashëgiminë e tyre marksiste-leniniste. Por paradoksalisht, statistikat ofrojnë të dhëna konkrete rreth treguesve të matshëm të pabarazive ekonomike e shoqërore që prodhojnë të tilla politika dhe në këto kushte ndërhyrja e qeverisë me qëllim zbutjen e këtij hendeku bëhet i domosdoshëm. Në këto rrethana ideologjia e majtë ka nevojë të artikulohet dhe të implementohet pasi është i vetmi udhëzues që mund të nxisë ndërhyrjet në treg. (Newman, 2005)

Gjithashtu, fakti që debatet mbi lirinë, barazinë, solidaritetin social, detyrimet politike, drejtësinë dhe moralitetin politik vazhdojnë të jenë të hapura tregojnë jo për fundin e ideologjisë sepse shpesh konvergjenca ideologjike ngatërrohet me fundin e ideologjive, pasi, fundi i ideologjive do të ishte fundi i politikës. E gjithë kjo frymë e përgjithëshme nuk mund të mos ketë ndikime në kontekstin shqiptarë dhe në strukturimin e programeve të partive politike. Pavarësisht këtij fakti, realiteti social, politike dhe ekonomik në Shqipëri e sjellin debatin për çështjen e ideologjizimit të partive politike në një rrafshë teorikë dhe praktik shumë specifik ku sigurisht, edhe influencat globale kanë peshën e tyre.

Influencat nga jashtë - Globalizimi, BE dhe NATO -

Rekomandimet që vinin nga Konferencat Globale të Kombeve të Bashkuara të mbajtura gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, arritën kulmin në Samitin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, në shtator të vitit 2000, ku 147 përfaqësues të niveleve të larta drejtuese miratuan « Deklaratën e Mijëvjeçarit ». Ky dokument përcaktojë disa piketa të emërtuara si « Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit » (OZhM) nëpërmjet të cilave synohej të garantoheshin disa të drejta themelore të njeriut si: të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor, strehim dhe siguri deri në vitin 2015. Në këtë kuadër, parlamenti shqiptar në korrik 2003, miratoi rezolutën mbi (OZhM), e cila përforconte detyrimin e qeverisë për të raportuar rregullisht në parlament mbi progresin e arritur me (OZhM). Kështu, Arta Dade Ministre e Jashtme gjatë legjislaturës socialiste 2001-2005 shprehet :“Si pjesë e proceseve afatgjatë reformuese

dhe të rritjes ekonomike, Shqipëria ka nisur të integrojë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit në objektivat kombëtare të zhvillimit. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Social-Ekonomik, e përgatitur kohët e fundit nga qeveria me mbështetjen e Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë, është përpjekja më e rëndësishme për të harmonizuar veprimtaritë e parashikuara në strategjitë kombëtare sektoriale me synimet e përcaktuara nga Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.” Të njëjtën gjë bëri edhe kualicioni i djathtë kur erdhi në pushtet. Në këto kushte, të gjitha forcat politike ishin të detyruara të angazhohen në përbushjen e detyrimeve që dikton OZHM-ve pavarësisht se cila forcë politike ishte në pushtet. Pra si Partia Socialiste ashtu edhe Partia Demokratike e kishin axhendën e reformave të paracaktuara.

Nga ana tjetër Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore kanë vite që janë përfshirë direkt në çështjet e qeverisjes me anë të projekteve të ndryshme që fokusohen në monitorimit, asistencës teknike dhe financiare të institucioneve shqiptare. Qeveritë duke qenë të detyruar të ndjekin udhëzimet e këtyre institucioneve qoftë edhe për shkak të varësisë nga pikëpamja ekonomike dhe financiare, kanë qënë të detyruara të ndjekin udhëzimet dhe rekomandimet e tyre duke krijuar luhatje ideologjike herë majtas dhe herë djathtas. Madje shpesh herë axhenda e tyre ekonomike është përcaktuar kryesisht nga influenca e këtyre institucioneve sesa nga problematika me të cilën përballet vendi apo nga platformat ideologjike që ata mbartin.

Një influencë tjetër negative në drejtim të aspektin ideologjikë lidhet me Integrimin e Shqipërisë në strukturat Europiane dhe Euroatlantike. Më konkretisht, në qershor 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE duke aspiruar anëtarësimin e saj të plotë në Bashkimin Europian. Nënshkrimi i MSA, përveç vlerës politike, ishte edhe një platformë e pastër reformash drejt arritjes së standarteve të BE në çdo aspekt të jetës politike, ekonomike dhe sociale. Qëllimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ishte vendosja e stabilitetit politik dhe ekonomik të vendit kandidat. Pikërisht për këtë arsye kjo marrëveshje përmbante detyrime asimetrike në favor të Bashkimit Europian. Shqipëria duhet të arrinte rezultate të larta në shumë drejtime, kryesisht në harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me standardet e BE-së duke adaptuar tërësisht 80 000 faqet e “acquis communautaire”.

E gjithë kjo procedurë ka një natyrë më tepër administrativ - teknike sesa ideologjik. Ky proces nga vet natyra e bën të parëndësishme ideologjinë dhe i shuan dallimet programore midis partive, duke i nxitur ato më shumë të garojnë mbi një program që ka të bëjë

me kohëzgjatjen dhe ritmin e teknikaliteteve të procesit të integritimit sesa me orientimet ideore që mund të zgjidhin çështje të ndryshme me natyrë social - ekonomike. Ky aspekt ilustron më së miri në programet e qeverisë 2005-2009 ku në lidhje me proceset integruese theksohet: “Për arritjen e këtij synimi programi i qeverisë do të zbatohet në përputhje me kërkesat e procesit integruese, duke i dhënë përparësi atyre drejtimeve që janë evidentuar qartësisht si prioritare dhe më problematike nga vlerësimet periodike të bëra me objektivitet nga Komisioni Europian”. Ndërsa në programin qeveritar 2009 – 2013 Kryeministri deklaroi se kjo qeveri do të jetë qeveria e integritimit dhe shpall si kryeprioritet ndërmarrjen e reformave që dikton BE. Ky paragraf dëshmon se sa pak besnike kanë partitë ndaj parimeve të veta ideologjike dhe se funksionet e ideologjisë në drejtimin apo formulimin e politikave janë krejtësisht të parëndësishme për shkak të paracaktimit të axhendave qeveritare që imponohen nga lartë.

Në këto rrethana, BE i ka kufizuar shumë alternativat mbi atë ç’ka shteti apo qeveritë mund të bëjë, dhe rrugët për arritjen e rezultateve. Modeli i shtetit i cili i ka bazat tek adaptimi i “acquis communautaire” krijon profilin e një shteti burokratik normash dhe standardesh që rregullojnë tregun dhe jo vetëm tregun ekonomik por edhe atë politik. Komisionerët dhe shtetet pjesëmarrëse të BE, janë të mendimit se “acquis communautaire” që ato eksportojnë nuk është një “model shteti” por disa nga praktikat më të mira teknike që mbulojnë tërë fushat e politikave publike. Ky imponim nga lartë për shkak të nevojave integruese bën të mundur që programet e forcave të ndryshme politike të përshtaten me prioritetet e parapërcaktuara dhe jo përcaktimi i prioriteteve të vendoset në bazë të programeve. Në këto kushte, forcat politike e kanë të parapërcaktuar rrugën që do të ndjekin dhe nuk mbetet gjë tjetër veçse të konkurojnë mbi baza të aftësisë manaxheriale dhe jo të ndonjë vizioni ideologjik. (Fuga, 2000).

Influencat nga brenda. - *Struktura sociale. Mos organizimi i grupeve të interesit\ Disintegrimi i lidhjeve shoqërore* -

Në teorinë e konkurrencës të partive, politologët ndër të tjera shpjegojnë se partitë vazhdimisht përceptohen si struktura që përafrojnë njerëzit me opinionet politike të ngjashme. Kryesisht në Liberal Demokracitë, diferencat ndërmjet partive qëndrojnë në planin e ideologjive që ato prezantojnë. Madje Down arrin në konkluzionin se vetëm ato parti të cilat mbështeten në ideologji të caktuara mund t’i rezistojnë kohës dhe konkurrencës politike.

Pavarësishtë këtij këndvështrimi, autor të tjerë e vendosin theksin jo shumë tek ideologjizimi sesa tek taktikat pragmatiste të partive për të maksimizuar votat e elektoratit. Në këtë kontekst kanalizohen dy linja arsytimi. Linja e parë, e gjykon ndërtimin e ideologjizimit të mbështetur tek disa tipare që i karakterizojnë partitë që nga themelimi edhe pse kushtet në të cilat janë themeluar mund të kenë ndryshuar dhe linja e dyte me natyrë konkurruese, e gjykon zhvillimin e ideologjive si shumë dinamika, pasi synon vazhdimisht të përshtatet me opinionet dhe vlerat e mbështetësve të tyre potencial. Siç kuptohet diferenca ndërmjet dy linjave qëndron në faktin sesa reaguese dhe të ndjeshme shfaqen partitë në raport me opinionet e votuesve.

Fakti që ideologjia bazohet tek identiteti i grupimeve të caktuara shoqërore dhe mbartet prej tyre është mjaft domethënës të trajtohen si e kanë krijuar identitetin e tyre grupet shoqërore gjatë periudhës postkomuniste dhe sa kanë influencuar ato tek partitë politike.

Në periudhës postkomuniste u krijuan grupe të ndryshme shoqërore duke dalë kështu nga masa homogjene karakteristike e periudhës së kaluar komuniste drejtë një mase heterogjene dhe pa formë. (Fuga, 2003) Ky riformësim i ndodhur si rrjedhojë e disa proceseve të ndryshme me natyrë ekonomike sociale dhe politike krijuan një shtresëzim shoqëror dinamik dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Pikërishtë, ky dinamizëm ka qenë një indikator mjaft i rëndësishëm për t'u kuptuar, pasi ndikon si tek sjellja e grupit ashtu edhe tek fluiditeti i parimeve të partive kryesore.

Një nga komponentët që ka influencuar më shumë në adres të fluiditetit të shtresëzimit social dhe lëvizjeve brenda grupit lidhet me lëvizjet demografike nga zonat rurale drejt atyre urbane dhe njëkohësisht drejtë vendeve të tjera jashtë Shqipërisë. Këto lëvizje demografike kanë ndikuar në ridimensionimin e marrëdhënieve shoqërore duke krijuar një pamje kaotike, pasi siç dihet, shoqëria në të tilla kushte vazhdon të jetë në kërkim të asaj që në gjuhën durkheimiane përkufizohet si solidaritetet organik. Kjo situatë u krijua si pasojë e shkëputjes së një pjese të madhe të popullsisë nga format e mëparshme të jetesës drejtë tendencave për të përqafuar disa forma të reja jetese nuk u jep mundësi atyre të krijojnë një identitet të qartë në "botën e re" ku po jetonë. Kjo masë e madhe njërësish duke e patur të vështirë të integrohen dhe të socializohen me të tjerët vazhdojnë të jenë në stadin "as..., as...." apo "edhe..., edhe...". (Fuga, 2008).

Sigurishtë, kjo krizë identiteti krijon vështirësi në stabilizimin e standardeve morale dhe sociale si dhe në identifikimin e tyre. Nga ana tjetër gjendja e atyre që vazhdojnë të migrojnë nga zonat rurale në ato urbane

është më e disintegroar nga pikëpamja e agregimit në bazë të interesave të përbashkëta. Organizimi i tyre shoqëror është në një profil mjaft të ulët.

Pavarësishtë këtyre lëvizjeve masive të shfaqura gjatë tranzicionit, sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT rezultojnë gati 50% e popullsisë që vazhdon të jetoi në zona rurale. Pjesa dermuese ndjek një model bujqësor të mbështetur kryesisht tek prodhimi njëherësh në sasira shumë të vogla dhe tek një blegtorie aspak intensive. Organizimi i tyre në bazë të interesave të mirëpërcaktuara e të dallueshme nuk është i dukshëm pasi zhvillimi bujqësor nuk është në nivelet e duhura, situatë e cila po të ishte ndryshe do të krijonte mundësinë për një solidaritet përmes identitetit të lidhur me këtë funksion në shoqëri. Kjo bën mundur të përballemi me një situatë ku në rang kombëtar të mos kemi ende ndonjë komunitet fermerësh të aftë të artikulojnë në mënyrë koherente interesat e tyre dhe të shërbejnë si grup interesi për ndikimin e politikës në përgjithësi apo politikave të veçanta në interesin e tyre. (Fuga, 2004) Është pikërishtë ky nivel i ulët i rendimentit që kap bujqësinë e sotme e cila ngërthen të gjithë krizën e saj.

Në këtë nivel të ulët organizmi shoqëror qëndrojnë edhe grupet e interesit në zonat urbane. Shkalla e organizmit dhe bashkëpunimit të grupeve të biznesit për shkak të stadi të zhvillimit ku ndodhen i ka penguar të konsolidojnë interesat e përbashkëta dhe të ndërtojnë strukturat për t'i mbrojtur këto interesa. Kjo situatë e paqartë shtrësisë dhe profilizimi nevojash sigurisht, ndikon negativisht në drejtim të krijimit të ideologjisë. Kjo për arsye se grupet, identitetet apo interesat e tyre nuk shërbejnë si bazë për pozicionimin parimor të politikave, por shërbejnë thjeshtë si konsumatorë të politikës.

Gjendja ekonomike e sociale e vendit

Vlerësimi i gjendjes ekonomike e sociale të vendit shërben si input për politikën e çdo qeverie dhe njëkohësisht edhe si sistem "feedbacku" për rezultatet e tyre. Problemet ekonomike e sociale në Shqipëri kanë patur ndikim të padiskutueshëm në mënyrën sesi janë hartuar politikën nga ana subjekteve politike. Ky ndikim në drejtim të deideologjizimit është i dukshëm si tek kampi i djathtë dhe i majtë duke qenë se impakti i këtyre faktorëve e ka bërë të djathtën të devijojë drejt së majtës apo të majtën të devijojë drejt të djathtës. Kështu, fakti që e djathta ndërmerr dhe zbaton politika të majta apo e majta zbaton politika të djathta i dedikohet përveç të tjerash edhe gjendjes jo të mirë ekonomike e sociale të vendit.

Ndikimi i ndryshimeve të shpejta dhe të gjithanshme social - ekonomike si dhe trysnia e krijuar nga dukuri të tilla që bashkëshoqërojnë tranzicionin si papunësia,

varfëria, flukset e larta të emigracionit, rritja e kriminalitetit dhe tronditja e vlerave tradicionale, strukturuan një stratifikim social ku peshën kryesore e zinin shtresat e ulta të popullsisë. Varfëria, si dukuri shumëdimensionale qëndroi në rrënjë të mjaft problemeve sociale të shfaqura në periudhën e tranzicionit. Varfëria, prodhoi përjashtim social dhe krijoi terrenin për rritjen e shkallës së riskut, marginalizimit dhe izolimit social të grupeve të marxhinalizuar të shoqërisë.

Grupet e marxhinalizuar dhe varfëria vazhdojnë edhe sot të përfaqësojnë dy kategori të ndërthurura dhe që ushqejnë njëra-tjetrën. Varfëria ekonomike reflektohet në problemet sociale me të cilat ballafaqohen sot disa kategori shoqërore si: të moshuarit e vetmuar, pensionistët, fëmijët e rrugës, personat me aftësi të kufizuar, të rinjtë e papunë dhe me sjelljet kriminale, gratë kryefamiljare, etj. Varfëria sipas studimeve të publikuara nga B.B, BERZH, PNUD tregojnë për një dimension rajonal dhe gjeografik.

Sipas statistikave dhe anketimeve të ndryshme të publikuar kryesisht nga Banka Botërore rezulton se më pak se 10 % e familjeve në qytet shpenzojnë katër herë më shumë sesa 90 % e familjeve të tjera, duke krijuar kështu një mini-shtresë të pasur shqiptare. Nga ana tjetër gjysma e shpenzimeve të familjeve orientohen për ushqime, ndërkohë që arsimimi dhe shëndetësia janë në fund të listës së shpenzimeve. Vrojtimet e realizuara nxjerrin në pah një fakt tashmë të pranuar gjerësisht nga shoqëria shqiptare, polarizimin e fortë midis shtresave të ndryshme sociale.

Një pjesë e mirë e këtyre diferencave vijnë për shkak të papunësisë, që sipas BERZH rezulton të jetë 2 herë më i lartë se shifrat zyrtare. Në një studim të realizuar nga ana e Agjencisë Qëndrore Amerikane është bërë e ditur se në Shqipëri, norma e papunësisë është mbi 30 % dhe shifra e saj zyrtare prej rreth 13% është fiktive pasi nuk përfshin në përlogaritje papunësinë në zonat rurale. Në këto zona vlerësohet se ekziston edhe pjesa më e madhe e forcës punëtore, ndërsa për këtë shifër në të dhënat zyrtare merret një normë papunësie zero. Disa nga problemet social - ekonomike që konstatohen nga ky studim paraqiten si më poshtë:

- *Kequshqyerja*. Sipas të dhënave të studimit, një në shtatë fëmijë në Shqipëri paraqet mangësi të theksuara në zhvillim, ndërsa një në tre paraqet mangësi të lehta në zhvillim.

- *Pjesmarrja në forcat e punës dhe papunësia*. Ka një korelacion të fortë midis varfërisë dhe papunësisë në Shqipëri, veçanërisht në zonat rurale. Referuar ILO (Zyra Ndërkombëtare e Punës) në lidhje me përkufizimet standarde të papunësisë rezulton se norma e papunësisë është pothuajse 10%, ndërkohë

që kjo shifër fsheh nivelin e lartë të papunësisë që ekziston në zonat rurale.

- *Përfshirja dhe gjinia*. Nivel i lartë diskriminimi gjinorë vërehet në tregun e punës. Shkalla e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës është pothuajse sa dy të tretat e asaj të meshkujve.

Ky realitet shërben si input për ndërmarrjen e politikave të ndryshme nga ana e qeverisë. Në këtë kontekst këto rrethana social - ekonomike ndikuan në mënyrën e qeverisjes nga të dyja kampet politike sidomos në drejtim të deideologjizimit të politikave qeverisëse. Ky efekt ishte më i dukshëm tek qeverisja e Partisë Demokratike, ku megjithëse kjo forcë deklarohet si e djathtë, politika të shumta që ndërmerreshin dëshmonin të kundërtën duke e bërë pozicionimin e saj ideologjik kontradiktor.

Në programet e qeverive socialiste dhe demokrate spikaste një inkoherencë e theksuar ideologjike nga çështja në çështje dhe gjithashtu vihej re një dominim i mendimit pragmatist dhe tejet teknik në çështjet themelore. Kështu, në sajë të inkoherencës nëse fillimisht tek programi i demokratëve kishin një qëndrim djathtist në vazhdim të të njëjtit program gjejmë një ligjërim dhe një ofertë krejt të majtë. Nga ana tjetër programi i socialistëve luhatej midis ligjërimin majtist që gjithësesi nuk ishte shumë i theksuar, dhe për më tepër atij djathtist.

Kështu, në një analizë të pozicionimit ideologjik të demokratëve dhe socialistëve në lidhje me ofertën e tyre për të qeverisur vihen re njëherazi konceptime dhe zgjidhje të pastra teknike e pragmatike, ku linjat e ndarjes mes të majtës dhe të djathtës nuk janë të dukshme. Më konkretisht, në forumin me titull "Colloquium Liberal" ku paraqiteshin tezat për një qeverisje të djathtë liberale, Kryetari i Partisë Demokratike Z. Sali Berisha në mënyrë kontroversiale me qëllimin e aktivitetit shprehet: "Shqipëria, për rrethanat e saj nuk mund të mos ketë një qeveri që të mos kujdeset për të papunët, që të mos kujdeset për të moshuarit... Vizioni ynë është një qeveri që do t'i përmbahet liberaldemokracisë, por me një vetëpërmbajtje të madhe, duke vlerësuar rast pas rasti e hap pas hapi ecurinë e reformave për të mos lejuar një dëm që mund të rëndojë në të ardhmen e vendit dhe që do të vështirësonte shumë realizimin e vetë reformave." Ky lloj artikulimi ishte në kontradiktë me përpjekjet për të ri-ideologjizuar të djathtën shqiptare. Partia Demokratike dhe koalicioni i djathtë fitoi të drejtën për të qeverisur dhe ky lloj artikulimi u formësua apo u përkthye në politika konkrete pa ndonjë shqetësim për linjën ideologjike që do të duhej të mbante. Në këtë kontekst, në lidhje me polarizimin e theksuar ekonomik të popullsisë në vënd kryeministri Berisha shprehet: "Buxheti duhet t'i japë përgjigje para

së gjithash këtyre çështjeve. Nuk mund të ecë ky vend në këtë mënyrë. Disa lahen me vaska floriri dhe të tjerë marrin ushqime me listë. Kjo nuk mund të vazhdojë më. Nuk mund të pranohet që disa të mos paguajnë dot kafshatën në një kohë që vendi ka 2 600 euro të ardhurat mesatare për frymë". Perceptimi i kësaj gjendje e shtyu qeverinë të ndërmarrë një sërë hapash të ngjashme si "Skema e kafshatës" për përmirësim të situatës. Kjo përpjekje pavaresisht se si gjykohet nga ana normative, është e qartë se nuk ka të bëjë aspak me mënyrën e djathtë të konceptimit e të veprimit.

Gjithashtu, edhe rivali i tij politik Z. Edi Rama gjatë fushatës të 2009 shprehet se Partia Socialiste nëse vjen në pushtet do të ndërmarrte një sërë reformash të rëndësishme për liberalizimin e tregut si dhe nuk do të ndryshonte politikën fiksale të ndjekur nga qeveria Berisha, por përkundrazi, do ta thellonte këtë reformë në adres të uljes së mëtejshme të barrës fiskale për biznesin. Pra kuptohet qartë se qeverisja e djathtë dhe opozita e majtë si rrjedhojë e rrethanave ekonomike - sociale të vendit i njohin vetes një sërë kufizimesh në drejtim të synimeve për t'i qëndruar besnik ideologjive që i përkasin.

Fragmentarizimi i partive politike.

Lloji i sistemit elektoral i një vendi ndikon drejtpërdrejt në ndërtimin e ideologjive si dhe në përfaqësimet partiake në parlament. Ky raport ndërmjet sistemit dhe konsolidimit apo zbehjes së ideologjisë ilustron edhe në rastin e Shqipërisë. Bazuar në aplikimin e sitemin proporcional rajonal, dy partitë e madhe PD dhe PS detyrohen të ndërtojnë koalicion me parti të vogla, por në anën tjetër edhe partitë e vogla nuk arrijnë të përfaqësohen në parlament nëse nuk bëhen pjesë e koalicionit me partitë e mëdha. Në këto rrethana, përlllogaritja e numrave dhe lëvizjet pragmatiste, zbehin ideologjitë dhe identitetet si pjesë dalluese e këtyre partive. Pra, partitë detyrohen të racionalizojnë veprimet e tyre në funksion të përfaqësimit në parlament dhe në qeverisje pavarësisht kostove në planin ideologjikë.

Kjo frymë pragmatiste e ndërtimit të koalicioneve padyshim influencën në konfiguracionin e qeverisë dhe të parlamentit. Aktualisht në kabinetin qeveritar dhe në parlament kemi përfaqësues të spektrit të majtë dhe të djathtë. Ky tip koalicioni mund të rrezikojë qëndrueshmërinë e qeverisë dhe cilësinë e vendimmarrjes. Kjo, jo vetëm për shkak të numrave në parlament që ka shumica por edhe për arsye të nevojës së mbrojtjes së interesave të elektoratit që përfaqësojnë. Qeveria në këtë rast nuk është e lirë që të adaptojë çdo lloj politike që dëshiron për arsye se anëtarët e partive të vogla pengojnë ato politika që shkojnë kundër vullnetit dhe preferencave të tyre.

Në këto rrethana lind nevoja që çdo projekt ligj i paraqitur në parlament për miratim duhet të konsultohet më parë me kryetarët e grupeve parlamentare si nevojë e ruajtjes së ekuilibrave brenda koalicionit. Tashme "imponimi" i drejtimit të qeverisë i lë vendin "negocimit" si kushtë i mbarevajtjes qeveritare dhe parlamentare. Cdo tentativë për ta injoruar këtë procedurë ka gjasa të krijoj probleme si në parlament ashtu dhe në qeverisje. Në këto kushte, ideologjitë e tentuar nga partitë i nënshtrohen përlllogaritjeve pragmatiste.

Si përfundim mund të shprehemi se mungesa e ideologjizimit nga njëra anë shihet si një fenomen i shkaktuar në masë të madhe nga pragmatizmi dhe prioritetet e elitës dhe nga ana tjetër nga roli i masës, kultura politike, sjelljet e votuesve dhe gjendja e tyre si bazë për inputin e proceseve politike. Por ideologjia është një element bazë për politikën sepse pa këtë dimension alternativat dhe ofertat politike nuk marrin kuptim. Politologu Down në lidhje me rolin e ideologjisë ndër të tjera shpjegon se në Liberal Demokratitë, diferencat ndërmjet partive qëndrojnë në planin e ideologjive që ato prezantojnë. Madje ai arrin në konkluzionin se vetëm ato parti të cilat mbështeten në ideologji të caktuara mund t'i rezistojnë kohës dhe konkurrencës politike. Sigurishtë, dimensionet që mbart fenomeni e bëjnë të vështirë pretendimin e Down por të paktën të fillohet të mendohet për ndërtimin e këtij dimensionit kaq të rëndësishëm për funksionimin dhe jetëgjatësinë e partive politike.

BIBLIOGRAFIA

- Bell. D. 2000 . *The End of Ideology*. Harvard University Press
- Colloquium Liberal. 2006 . *Teza për një Qeverisje të Djathtë Liberale*. DITA 2000
- Freedon.M. 2003. *Ideology: A Very Short Introduction*. Oxford. Oxford University Press
- Freedon. M. 2001. *Reassessing Political Ideologies* . London Routledge
- Fuga.A. 2003. *Majtas Jo Djathtas*.Tiranë.ORA
- Fuga. A. 2000. *Shoqëria periferike*.Tirane:Ora
- Fuga.A. 2005. *Lexime ne Komunikim*.Tirane: Ora
- Heywood.A. 2007. *Political ideologies, An introduction*. New York . Palgrave Macmillan.
- Mair .P. 1990 . *The West European Party System*.Oxford. Oxford University Press.
- Newman. M. 2005. *Socializmi, një Hyrje e Shkurtër*.Tiranë. Ideart
- Steger M. B. 2003 . *Globalization: A Very Short Introduction*. Oxford University Press.

Lami

Dokument i Bankës Botërore .2006.
“Shqipëria,Ristrukturimi i shpenzimeve publike”.vol II.
Tiranë
2002 “Shqipëria dhe Objektivat e Mijëvjeçarit”. HDPC.
Tiranë

www.undp.org.al . Parë për herë të fundit me
20.12.2009
<http://web.worldbank.org> . Parë për herë të fundit me
10.01.2010